



Npi – 01/124 datë: 03.04.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d), nenin 17 shkronja (c), nenin 58 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenet 4, 7 dhe 8 të Ligjit Nr.03-L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010; Nenin 53 dhe 54 pika 2 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Nr.02/169 të datës 18.02.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, në seancën e mbajtur më 03.04.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM, OBJEKTIN AFARISTO-BANESOR (PARA NDËRTESES SË KOMUNËS)

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, me shumicën e votave miratoi, vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm, Objektin Afarist-Banesor (para ndërtesës së Komunës) me të gjitha njësitë afariste-banesore, me numër nr. O-72809093-01667-1-2-0, i cili është i vendosur në Ngastrën Kadastrale P-72809093-01667-1, Zona Kadastrale Shtime. Adresa: Rr. "Tahir Sinani" p.n. Shtime.

II

A r s y e t i m: Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm është si vijon: Realizimi i Projektit "Ndërtimi i Sheshit dhe Parkingut Nëntoksor në Shtime.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi e Kuvendit
Adnan Ademi